# DËSHMI ARKIVI

**A-439100**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Nga stoli në hero, historia e çmendur e Moreiras që përmbysi Lazio-n në Olimpico |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/12/nga-stoli-ne-hero-historia-e-cmendur-e-moreiras-qe-permbysi-lazio-n-ne-olimpico/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 12 shtator 2026, 21:55:14 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 12 shtator 2026, 21:49:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 12 shtator 2026, 21:48:00 UTC → 12 shtator 2026, 21:50:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `b91b9636c5caae8f4006160fc1f3b3ce8207ac100e9a99c4842cb88e94ba01a5` |
| TEKSTI | `dc5799b363ffc60ea4f0127dd9d837d0bbd6d2b1229e348589fd542c539a7c4c` |
| PAMJA | `e4aab1f43e505761ecec60c90c06078dc823d01ae2907bb15af4e6882b99d2d2` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `480bf26681c785c369960b79741c371d7baa266f4795415a6477a7a9ceb3c5a8` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `b30f55abd1a1da893f6f2b70493279595f2d48f7f75f201089c9c3cfb8367729` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/480bf26681c785c369960b79741c371d7baa266f4795415a6477a7a9ceb3c5a8`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Nga stoli në hero, historia e çmendur e Moreiras që përmbysi Lazio-n në Olimpico

12/09/2026 23:49




**Ndonjëherë mjaftojnë 45 minuta për të ndryshuar perceptimin për një futbollist. Diego Moreira e bëri këtë në Olimpico, ku hyri në fushë pa shumë pritshmëri dhe doli prej saj si heroi i Milanit.**

Anësori i afruar për 50 milionë euro kishte lënë shumë pikëpyetje pas debutimit me Juventusin. Në Torino, Moreira ishte dukur i pasigurt, larg pritshmërive dhe me një problem të madh në administrimin e topit. Por ndaj Lazios gjithçka ndryshoi.

Amorim e aktivizoi në pjesën e dytë dhe zgjedhja për ta vendosur në krahun e majtë rezultoi perfekte. Moreira shfrytëzoi hapësirat, luajti më lirshëm dhe me dy goditje fantastike me të majtën shënoi dy gola që ndryshuan komplet rrjedhën e takimit.

“Jam shumë i lumtur për dy golat e mi të parë, por do të isha edhe më i lumtur nëse do të kishim fituar. Bëmë një pjesë të dytë të madhe dhe meritonim më shumë”, tha Moreira pas ndeshjes. Ai gjithashtu iu përgjigj atyre që e cilësuan të ndrojtur në debutimin kundër Juventusit.

“Nuk do të thoja se isha i ndrojtur. Për mua ishte hyrja në kampionatin italian dhe ndodhi kundër një skuadre të madhe. Sot luajta në të majtë, por mund të luaj në të dy krahët. Trajneri bëri një zgjedhje shumë të mirë duke më vendosur majtas. Të shohim ku do të luaj ndeshjen e ardhshme”, u shpreh ai.

**Por kush është në të vërtetë Diego Moreira?**

I lindur në vitin 2004, me origjinë nga Guinea-Bissau dhe i rritur në futbollin belg, Moreira është një futbollist që mund të mbulojë disa pozicione. Në formimin e tij të hershëm ai përfaqësoi edhe Portugalinë në ekipet e moshave, ndërsa me Benfikën fitoi UEFA Youth League si protagonist. Pozicioni i tij natyral është ai i anësorit, por mund të luajë edhe si trekuartist dhe, nëse është e nevojshme, edhe më prapa në krah.

Vetë Moreira pranon se ndihet më mirë në të djathtë, por ndaj Lazios Amorim e përdori në të majtë dhe vendimi rezultoi një goditje taktike e goditur.

Aftësitë më të spikatura të tij janë driblimi dhe shpërthimi në shpejtësi. Kur ka hapësirë për të sulmuar, Moreira mund të bëhet jashtëzakonisht i rrezikshëm. Por talenti ka edhe anën tjetër. Vazhdimësia, puna në fazën mbrojtëse dhe pastërtia në veprime kanë qenë ndër problemet e tij. Kundër Juventusit, për shembull, humbi 18 topa.

Në Olimpico ishte një tjetër lojtar. Më i lirë, më agresiv dhe më i sigurt në veprimet e tij. Dy golat nuk janë vetëm një dopietë në statistikë. Mund të jenë momenti që ndryshon sezonin e Diego Moreiras dhe, mbi të gjitha, mënyrën se si Milani e sheh tashmë një prej investimeve të tij më të shtrenjta. Nga “objekt misterioz” pas debutimit me Juventusin, në protagonist të madh në Olimpico. Për Moreiran, ndoshta sezoni i vërtetë sapo ka

## SPORT • KRYESORE



U dhunua shtatzënë gjatë grabitjes, humbi fëmijën, 9 vite burg për “trurin” e sulmit ndaj Donnarummës dhe partneres së tij



Show i golave në Romë, Moreira i prish festën Lazios, Milan merr një pikë të çmuar



Renditja e Superiores/ Si ndryshon pozicionimi i skuadrave pas 3 ndeshjeve të para të javës së katërt



La Liga/ Real Madrid kthehet te fitorja, mposht Rayo Vallecanon e Ivan Balliut dhe i bashkohet Barcelonës në krye



Shqipëria e Maranit para provës së parë, nga kriza e Strakoshës te forma e Manajt, kush e fiton ftesën

## ME TË LEXUARAT

U dhunua shtatzënë gjatë grabitjes, humbi fëmijën, 9 vite burg për “trurin” e sulmit ndaj Donnarummës dhe partneres së tij

Ekskluzive/ Dramë në Lezhë, Trashi



Arsenal vazhdon të jetë perfekt, i imponohet Sunderlandit dhe është me 12 pikë të plota

12/09 22:58



Cagliari vijon me formën e mirë, gjunjëzon Atalantën dhe e sheh veten në vendin e katërt

12/09 22:39



Renditja e Superiores/ Si ndryshon pozicionimi i skuadrave pas 3 ndeshjeve të para të javës së katërt

12/09 21:24

## Na ndiqni:

Top Channel | Top Channel - Sport | @topchannelalbania | Top Channel

## Video »



Top Channel/ Jepet alarmi për AI: Më e rrezikshme nga sa e mendojmë



Top Channel/ Protesta rrethon Kryeministrinë, policia zbret në shesh



Top Channel/ Harta e re, Rama i prerë: Bashkim do bëhet, mbyllet brenda 2031



Top Channel/ Kapet në Greqi vrasësi shqiptar, "koka" e kokainës në trëndafila



Top Channel/ Berisha vjen nga SHBA: Udhëtimi ripërtëritës i jetë sime!



Top Channel/ Vdekja e Mazonakis, mjeku ngre alarmin, thirrje qytetarëve: Kujdes me terapitë për...



© Top Channel 2001 - 2026 · Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.